

KËSHILLTARËT BASHKIAKË MË EFEKTIVË

BAZUAR NË ANGAZHIMIN NË MEDIA DHE NË DALJET PUBLIKE

TIRANË, KAMËZ, KAVAJË, VORË DHE RROGOZHINË



RAPORT MONITORUES

Ky raport u realizua me mbështetjen e Lëviz Albania në kuadër të projektit “BASHKITË E QARKUT TIRANË: TRANSPARENCA, QEVERISJA QYTETARE DHE LLOGARIDHËNIA”.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve të ISP dhe nuk përkojnë detyrimisht me qëndrimet Lëviz Albania.

EKIPI REALIZUES

Drejtues
Afrim Krasniqi

Ekipi monitorues

Rudina Niklekaj
Brunilda Duriçi
Aida Kastrati

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2018

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
Web: www.isp.com.al
Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com
Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies
Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

HYRJE

Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Lëviz Albania (LA) po kryen hulumtime në nivele të ndryshme të aktivitetit të këshillave bashkiakë dhe të bashkive të qarkut Tiranë (Tiranë, Kavajë, Kamëz, Vorë e Rrogozhinë).

Projekti “Bashkitë e qarkut Tiranë: transparenca, qeverisja qytetare dhe llogaridhënia” kanë në fokus edhe matjen e detajuar të efektivitetit të secilit nga këshilltarët (ata me mandat të plotë ose të pjesshëm) në secilën bashki, ku pjesë e rëndësishme e vlerësimit bëjnë pjesë të gjitha aktivitetet e këshilltarëve, - nismat, debatet, përfaqësimi, roli, aktet publike, angazhimi në media, takimet me qytetarët, llogaridhënia, transparenca, konflikti i interesit, etj.

Në këtë relacion reflektohen të dhënat e monitorimit mbi standardin e angazhimit të këshilltarëve në media të ndryshme, kryesisht në mediet online, gjatë periudhës shtator 2015 – shtator 2018.

Në dallim nga parlamenti kombëtar (Kuvendi i Shqipërisë) parlamentet lokale (këshillat bashkiakë) nuk përbëjnë lajm ditor dhe nuk kanë transmetim direkt në TV dhe media. Vetëm në rastet e zhvillimeve të rëndësishme vendore media tregon interes të madh, kryesisht duke i dhënë mbështetje kryetarëve të bashkive, pavarësisht forcës politike që ata i përkasin. Në rastet e mbledhjeve rutinë, media ka interesa të limituara për transmetim. Për shkak se edhe në bashkitë e sotme nuk ka media zyrtare të vetë bashkive (TV, radio, blog, gazetë, revistë, etj) këshilltarët ndeshen me vështirësi për të gjetur rrugët e duhura të komunikimit direkt me qytetarët.

Komunikimi i të zgjedhurve me zgjedhësit është standard demokracie dhe mirëqeverisje, kërkesë minimale drejt një modeli llogaridhënës, dhe tregues i pjekurisë politike në një sistem periodik zgjedhor, ku mundësitë për CV të pasur përfaqësimi janë të kushtëzuara edhe nga bashkia, rrethanat politike, buxheti, raportet politike, gjendja ekonomike, etj.

Një këshilltar i angazhuar është i interesuar të ketë komunikim të vazhdueshëm me qytetarët, të marrë prej tyre shqetësime dhe sugjerime dhe të japë informacion mbi aktivitetin e tij, të njihet me prioritetet e zonës zgjedhore dhe të krijojë harmoninë e duhur midis prioriteteve të zonës dhe prioriteteve të vetë bashkisë.

Në modelin shqiptar të përfaqësimit lokal këshilltarët nuk janë vetëm llogaridhënës përpara qytetarëve, por kryesisht edhe përpara partisë së tyre politike, mbështetësve partiakë dhe liderëve partiakë që i kanë emëruar.

Bazuar në këtë mision, interes dhe përgjegjësi të shumëfishtë, këshilltarët në modelin shqiptar të përfaqësimit kanë dy kategori mjetesh komunikimi në dispozicion:

- a) Komunikimi në formën tradicionale (takime në zonën elektorale, konsultime të vazhdueshme, takime me grupet e interesit, mbledhje, anketime, etj)**
- b) Komunikimi përmes medieve të reja (rrjeteve sociale, medieve online, telefonit, etj)**

Në rastin e parë hapësira e këshilltarëve për komunikim është e kufizuar, edhe sepse numri i takimeve dhe konsultimeve nuk është asnjëherë i atillë sa të ketë kontakt me pjesën më të madhe të komunitetit lokal dhe se axhenda e takimeve kushtëzohet nga partia dhe axhenda e saj, e cila shpeshherë është e ndryshme nga axhenda individuale e këshilltarit lokal. Në këto rrethana, metoda më e suksesshme e viteve të fundit në demokracitë funksionale dhe ato hibride, është komunikimi duke përdorur fuqinë e medias online, rrjeteve sociale dhe formave moderne të komunikimit teknologjik.

Duke kërkuar përvoja pozitive referuese, po ilustruam përvojën e këshillit bashkiak Tiranë, i cili ofron disa modele referuese pozitive në këtë drejtim: për shembull, ka këshilltarë që bëjnë publike rendin e ditës të Këshillit Bashkiak me dokumentacionin shoqëruar duke kërkuar opinionet e qytetarëve që përdorin teknologjitë e reja të informacionit; ka këshilltarë që kanë faqe të dedikuara interneti me informacione të larmishme mbi aktivitetin dhe problematikat lokale; ka këshilltarë me faqe të dedikuara në rrjetet sociale ose me network të rregullt komunikimi me medien, me grupet e interesit apo organizatat civile në zonën elektorale.

A përbëjnë këto praktika modele dominuese apo përjashtuese pozitive? Hulumtimi nga Instituti i Studimeve Politike tregon se kemi të bëjmë me modele përjashtuese pozitive, - me vetëm një numër të kufizuar individësh, të cilët kanë aftësinë, vizionin, përkushtimin dhe sensin e përgjegjësisë për të gjetur forma sa më atraktive të komunikimit të vazhdueshëm me elektoratin.

Në tërësinë e të dhënave për këshilltarët, rezulton se dominues është modeli tradicional, - rendja pas axhendës së partisë, qëndrimi inaktiv, prirja drejt takimeve me elektoratin kryesisht në prag të fushatës elektorale dhe ngjarjeve të rëndësishme politike, etj. Numri i këshilltarëve që përdor teknologjitë e reja të komunikimit për lidhje me komunitetin votues, është rritur në krahasim me vitet e kaluara, por është ende minimal në krahasim me secilin vend tjetër evropian me standarde demokracie përpara Shqipërisë.

METODOLOGJIA

Ekipi i ISP ka monitoruar aktivitetin e këshilltarëve bashkiakë në pesë bashkitë e qarkut Tiranë bazuar në të dhënat e tyre në disa burime alternative: në profilet në mediet sociale facebook dhe twitter për periudhën nga zgjedhja dhe deri në shtator 2018, si dhe në mediet online newsbomb.al, javanews.al, lapsi.al, politiko.al, syri.net, faktor.al, si dhe gazetatat gazetatema.net, panorama.com.al, shekulli.com.al, shqiptarja.com etj, për periudhën janar-shtator 2018.

Duke qenë praktikë e parë monitoruese në këtë formë monitorimi, ISP, me përvojë monitorimi të nivelit të efektivitetit edhe të Kuvendit të Shqipërisë, u fokusua jo thjesht në aktivitetin ligjor të këshilltarëve në bashki, por edhe në raportin e tyre publik me qytetarët votues. Lidhur me aktivitetin në këshillin bashkiak (pjesëmarrje në komisione, pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit, propozime, diskutime, seanca pyetjesh, etj) ISP është duke kryer një monitorim të detajuar, rezultatet e të cilit do të bëhen publike në vijimësi të projektit monitorues. Në funksion të këtij procesi, ISP i ka adresuar të gjithë këshilltarëve të secilës nga pesë bashkitë e qarkut (në formë elektronike dhe në rrugë postare përmes sekretarisë së këshillit bashkiak) një formular me të dhëna nga secili këshilltar mbi bilancin e punës së tyre, problematikat, problemet dhe sugjerimet për përmirësim. Komunikimi midis ISP e këshilltarëve lidhur me këtë të dhëna është në proces, dhe reagimi i këshilltarëve ka qenë në tërësi pozitiv (bashkia Tiranë, Vorë, Kamëz e Kavajë) dhe më pak pozitiv (Bashkia Rrogozhinë).

Bazuar në metodologjinë e ndjekur ky raport reflekton kryesisht bilancin e profileve në mediet sociale dhe aktivitetit të dedikuar ndaj problematikave të ndryshme lokale të secilit këshilltar në pesë bashkitë në monitorim. Janë lënë jashtë analizës dhe trajtimit rastet e deklarimeve apo angazhimeve të ndryshme publike mbi jetën private, tematika jashtë përgjegjësisë së këshilltarit/es apo replika e citime për pjesëmarrje në aktivitete, ceremoni e ngjarje të tjera të karakterit personal apo protokollar, si tregues që nuk lidhen me funksionet në këshillin bashkiak.

Nga deklaratimet në mediet janë evidentuar të dhënat sasiore (numri i daljeve apo deklarimeve) dhe cilësore (përmbajtja e tyre dhe lidhja me funksionin e këshilltarit/es në bashki. Referuar në këto të dhëna, është bërë renditja në kategori të ndryshme: “shumë aktivë” - me aktivitete publik të vazhdueshëm mujor lidhur me problematika të funksioneve në këshillin bashkiak; “pjesërisht aktivë” - me aktivitete të shkëputur në kohë dhe me deklarime apo aktivitete të pakët lidhur me funksionin në këshillin bashkiak; “pak aktivë” - me “gjurmë” minimale të deklarimeve, aktivitetit apo angazhimit publik lidhur me përgjegjësitë në funksionin në këshillin bashkiak; “jo aktivë” për rastet e profileve të hapura kryesisht në fushatat elektorale për zgjedhjet lokale ose parlamentare, por pa gjurmë aktiviteti në lidhje me funksionin në këshillin bashkiak apo aktivitete të tjera politike, si dhe “s’ka komunikim” për rastet kur është e pamundur të gjendet një profil apo gjurmë mediatike (mediet sociale e të shkruara) për emrin e këshilltarit apo funksionin e aktivitetit e tij.

PROBLEMATIKA DHE KRAHASIME NË NIVEL BASHKISH & QARKU

Pjesë e rëndësishme e vlerësimit të efektivitetit të këshilltarëve bashkiakë janë rezultatet e dala nga monitorimi i nivelit të aktivizimit të këshilltarëve në mediet e ndryshme online (përfshirë faqe të dedikuara online, aktiviteti në facebook, instagram, twitter, etj). Për shkak se monitorimi 4 vjeçar vjen në kontrast me mandatet e ndryshme kohore të këshilltarëve dhe se vetë projekti i ISP ka kufizim në shtrirje kohore, procesi monitorues u fokusua vetëm për periudhën qershor 2018 - mars 2019. Disa prej këshilltarëve aktual të bashkive kanë mandate të plota 3 vjeçare, disa kanë mandate të reja disa mujore dhe në muajt e ardhshëm pritet të ketë ndryshime të reja në përbërjen e këshillave bashkiakë.

Monitorimi ka nxjerrë në pah faktin se në tre nga pesë bashkitë në monitorim (Kamëz, Vorë, Kavajë) ka pasur këshilltarë, të cilët edhe pse të emigruar në vende të tjera larg Shqipërisë, zyrtarisht vijuan të ishin këshilltarë dhe të konsideroheshin zyrtarë lokalë në bashkitë respektive, për periudha të ndryshme kohore. Në secilën bashki, përfshirë Bashkinë Tiranë ka këshilltarë, të cilët për një vit kalendarik nuk kanë marrë pjesë fare në mbledhjet e këshillit bashkiak, - “gjurma” e vetme institucionale e ushtrimit të funksionit të tyre. Të dhënat e detajuara do të jenë pjesë e një raporti tjetër monitorues që lidhet me përfaqësimin politik në nivel qarku dhe përputhshmërinë midis përfaqësimit dhe pritshmërive qytetare, në kontekstin e llogaridhënies dhe transparencës publike.


Lidhur me gjendjen aktuale të këshillave bashkiake, duhet theksuar paraprakisht se për shkak të legjislacionit zgjedhor dhe kushtetues, të cilat krijojnë papajtueshmëri midis funksioneve të deputetëve dhe zyrtarëve të lartë ekzekutiv me detyrën e këshilltarët, në periudha të ndryshme, sidomos pas zgjedhjeve parlamentare 2017, pati ndryshime të rëndësishme në përbërjen e grupeve të këshilltarëve në Bashkinë Tiranë.

Ndryshime u shënuan edhe në bashkitë e tjera, sidomos në Kavajë, ku më 2017 pati zgjedhje të parakohshme për kryetarin e bashkisë, pas shkarkimit të ish kryetarit në vijim të procesit të de-kriminalizimit. Ikja e disa këshilltarëve me përvojë në funksione më të larta, përfshirë edhe hyrjen në parlament, solli zëvendësimin e tyre nga këshilltarë të listës vijuese partiake, shumica e të cilëve nuk përbëjnë zgjedhjen e parë të vetë partisë propozuese politike.

Tipar tjetër i aktivitetit të këshilltarëve në Tiranë dhe bashkitë e tjera të qarkut është lëvizja e këshilltarëve nga njëri grup në tjetrin, kryesisht në drejtim të mazhorancës. Vetëm në Tiranë ka ndodhur që një këshilltar në koalicionin drejtues të qytetit të largohet nga partia dhe rrjedhimisht edhe nga shumica në qeverisje, në drejtim të opozitës (këshilltarja Mirela Bogdani).

Në këshillin bashkiak Tiranë u krijua një problematikë e gjatë juridike dhe gjyqësore me konfliktin mbi legjitimitetin e gjashtë këshilltarëve.

Fillimisht në muajin shkurt 2018 Gjykata Administrative vendosi pavlefshmërinë për gjashtë mandatet e reja, duke krijuar debate legjitimiteti mbi vendimmarrjet e gjashtë këshilltarëve në këshillin bashkiak për një periudhë 7 mujore (korrik 2017 – shkurt 2018). Çështja vijoi të shkaktojë debat, por në korrik 2018 Gjykata e Apelit ndryshoi vendimin e nivelit të parë dhe njohu legjitimitetin e mandatit dhe aktivitetit të gjashtë këshilltarëve.



Në dhjetor 2017 katër këshilltarë të LSI bashkuan votat me grupin e këshilltarëve të PS, duke ndryshuar edhe përkatësi politike në këshill. Ata ishin Genta Mezini, Agim Kraja, Bora Panajoti dhe Naim Halili. Lëvizja e tyre nuk ishte as e para dhe as e fundit qoftë në Këshillin Bashkiak Tiranë dhe as në nivelin e bashkive të qarkut Tiranë.

Sipas të dhënave monitoruese të marra nga burimet zyrtar në KQZ rezulton se numri i ndryshimeve në këshillat bashkiak të pesë bashkive në tri vitet e fundit arrin në 24% e të gjithë trupës së këshilltarëve, rreth një e katërta e të gjithë këshilltarëve.

QARKU TIRANË: NGA 175 KËSHILLTARË, - 12% JANË AKTIVË NË MEDIA ONLINE

Të dhënat e evidentuara nga monitorimi kanë vlerë të veçantë nëse merren në kontekstin krahasues brenda vetes (midis bashkive e të njëjtit qark) dhe në nivel më të gjerë (rajonal). Duke bërë krahasime të tilla dalin më në pah gjetjet dhe tiparet kryesore. Në rastin konkret, përmes kësaj metode del në pah fakti se numri i këshilltarëve që kanë kuptuar forcën e medias dhe e kanë përdorur atë në funksion të angazhimit dhe përgjegjësisë së tyre politike e publike, është jashtëzakonisht i vogël.

Po të krahasohen të dhënat me vendet e tjera rajonale, si për shembull, Sllovenia, rezulton se në këshillin bashkiak Lubjanë mbi 90% e këshilltarëve përdorin mediet online dhe janë në komunikim të vazhdueshëm përmes tyre me elektoratin. Në disa kryeqytete të tjera ballkanike shifra shkon në 60-80%. Në këshillin bashkiak Tiranë vlerësimi “shumë aktivë” përfshin vetëm rreth një të katërtën e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

ANGAZHIMI PUBLIK I KËSHILLTARËVE (NË NR)

— TIRANË — KAMËZ — KAVAJË — RROGOZHINË — VORË





Tabela krahasuese mbi aktivitetin e këshilltarëve mediatik në pesë bashkitë e qarkut Tiranë, bën edhe paraqitjen sipas nivelit të efikasitetit për secilën bashki dhe këshill bashkiak.

Tabelat reflektojnë leximin numerik (numrit të këshilltarëve aktivë dhe në nën kategoritë e tjera), si dhe të shprehur në përqindje në raport me numrin total të këshilltarëve për secilën bashki. Në vlerësimin numerik në nivelin “shumë aktivë” Tirana është kryesuese ndaj bashkive të tjera; në nivelin “pjesërisht aktivë” Tirana është e vetmja bashki me rekorde vlerësuese, në nivelin “pak aktivë” ka rritje nga tri bashkitë e tjera Kamëz, Kavajë e Rrogozhinë. Në nivelin “jo aktivë” rekord janë Tirana e Kamza me nga 19 këshilltarë, ndjekur nga Vora me 14 dhe Kavaja me 10 këshilltarë.

Në leximin krahasimor shprehur në vlera relative (përqindje midis numrit të këshilltarëve për secilën kategori dhe numrin total të këshilltarëve për secilën bashki), të dhënat janë edhe më të qarta për të bërë diferencën midis bashkive. Konkretisht, në Tiranë vetëm një e katërta e këshilltarëve janë “shumë aktivë”, ndërkohë që rreth 50% janë jo aktivë ose pa asnjë komunikim mediatik në aktivitetin e tyre. Raporte të tilla për këshillin më të madh bashkiak në vend, ku ka edhe prani më të madhe mediatike dhe mundësi më të mëdha komunikimi, janë tregues kritik të gjendjes dhe disnivelit midis pritshmërive qytetare ndaj bashkive e mënyrës sesi këshilltarët e ushtrojnë funksionin e tyre.

ANGAZHIMI PUBLIK I KËSHILLTARËVE (NË VLERË)

— TIRANË — KAMËZ — KAVAJË — RROGOZHINË — VORË




Të dhëna edhe më kritike gjenden në bashkitë e tjera të qarkut Tiranë. Konkretisht, pothuajse 95% e këshillit bashkiak Vorë është tërësisht inaktiv në komunikimet e ndryshme mediatike ose nuk ka asnjë gjurmë komunikimi publik. Po ashtu, 83% e këshilltarëve të bashkisë Kamëz apo 86% të bashkisë Rogozhinë nuk kanë gjurmë komunikimi publik dhe as bilanc të angazhimit mediatik.

Sipas kategorive, Këshilli Bashkiak Tiranë ka përqindjen më të lartë në kategorinë “shumë aktivë” me 25%, këshilli bashkiak Tiranë ka përqindjen më të lartë në kategorinë “pjesërisht aktivë” me 16%, këshilli bashkiak Kavajë ka përqindjen më të lartë të këshilltarëve “pak aktivë” me 42%, këshilli bashkiak Vorë ka përqindjen më të lartë në kategorinë “jo aktivë” me 67% dhe këshilli bashkiak Rogozhinë ka përqindjen më të lartë në kategorinë “s’ka komunikim” me 62% të këshilltarëve.

Klasifikimi në përqindje në nivel qarku dhe në tërësi për të gjithë këshilltarët lehtëson kuptimin më të mirë të diferencave midis këshilltarëve që kanë efektivitet më të lartë të prezencës në mediet online. Siç lexohet edhe në tabelë, vetëm 12% janë shumë aktivë në nivel qarku, pjesërisht aktivë janë vetëm 6%, jo aktivë është kategoria dominuese me 39%, pak aktivë janë 15%. Kategoria e dytë më e madhe është ajo e këshilltarëve pa aktivitet e gjurmë në media, në total 28% e të gjithë numrit.

VLERËSIMI NË PËRQINDJE I KËSHILLTARËVE NË NIVEL QARKU

■ SHUMË AKTIV ■ PJESËRISHT AKTIV ■ PAK AKTIV ■ JO AKTIV ■ NUK KA KOMUNIKIM




Kjo do të thotë se këta këshilltarë nuk aplikojnë asnjë formë bashkëkohore të komunikimit me publikun dhe me zgjedhësit e tyre. Në rastin më të mirë ata vijojnë formën tradicionale të komunikimit direkt me zgjedhësit e zonës, në rastin më të keq nuk janë të interesuar për komunikim publik dhe me këtë shmangin edhe mundësinë e përbaljes direkt me qytetarët apo me bilancin e mbajtjes së premtimit të tyre gjatë viteve në këshillin bashkiak.

5 BASHKITË E QARKUT TIRANË: 22 KËSHILLTARËT MË EFEKTIVË

Tirana supozohet të jetë modeli më i mirë i aktivizimit përmes medieve ndihmëse online. Sipas të dhënave të stafit monitorues të ISP rezulton se “shumë aktivë” në mediet e ndryshme online, janë 26% e këshilltarëve të bashkisë Tiranë, “pjesërisht aktivë” janë 16%, “pak aktivë” me aktivitete gati simbolik janë 10% e këshilltarëve.

Në kategorinë “jo aktivë” me status të pandryshuar për një kohë shumë të gjatë rezultojnë 31% e këshilltarëve dhe pa asnjë gjurmë komunikimi në mediet e ndryshme online janë identifikuar 16% e këshilltarëve.



Tregues simbolik më rëndësi është fakti se shumica e atyre këshilltarëve që nuk janë aktivë ose që kanë aktivitet simbolik, kanë lënë gjurmë online vetëm në periudhën e fushatës elektorale për zgjedhjet lokale 2015 apo parlamentare 2017. Pjesën tjetër të kohë midis fushatave elektorale nuk kanë “gjurmë” duke dëshmuar se mund të kenë qenë nxitur nga partia e tyre politike ose nga klima e përgjithshme zgjedhore në vend.

Lista e këshilltarëve më me shumë aktivitet mediatik në bashkitë e qarkut Tiranë, bazuar në rendje alfabetike të emrave, ndodhet më poshtë.


NR	EMER	MBIEMER	BASHKIA
1	AKIL	KRAJA	TIRANË
2	ALDRIN	DALIPI	TIRANË
3	ALTIN	SUBASHI	VORË
4	AMELA	TANUSHI	KAMËZ
5	ARDIT	ÇELA	TIRANË
6	BESNIK	ALIAJ	TIRANË
7	BILBIL	BAJRAKTARI	KAMËZ
8	BLERINA	DORACAJ	TIRANË
9	BORA	PANAJOTI	TIRANË
10	DORINA	KUKA	TIRANË
11	ENI	PËLLUMBI	TIRANË
12	ELTJON	HALIMI	TIRANË
13	ERIONA	BIXHA	TIRANË
14	FABIAN	TOPOLLARI	TIRANË
15	KRESHNIK	ÇOLLAKU	TIRANË
16	KUJTIM	ÇERPJA	KAMËZ
17	LEONARD	OLLI	TIRANË
18	MATEO	SPAHO	TIRANË
19	MEGI	KATROSHI	KAVAJË
20	MIRELA	BOGDANI	TIRANË
21	REJLA	BOZDO	TIRANË
22	SULEJMAN	RUSTEMI	KAVAJË

Në listë bëjnë pjesë 22 këshilltarë, nga të cilët 16 janë të këshillit bashkiak të bashkisë Tiranë, 3 nga këshillit bashkiak i bashkisë Kamëz, 2 nga këshilli bashkiak i bashkisë Kavajë, 1 nga këshilli bashkiak i bashkisë Vorë, ndërkohë që mungojnë vlerësimet maksimale për ndonjë nga anëtarët e këshillit bashkiak të bashkisë Rrogozhinë, për shkak të nivelit minimal të angazhimit të tyre.

Në vlerësimin gjinor të angazhimit tyre rezulton se këshilltarët meshkuj kanë nivel të lartë angazhimi me 60% ndaj 40% këshilltare gra e vajza. Kjo e dhënë është me interesa për shkak se bashkia Tiranë është e vetmja bashki në nivel republike që ka numër e përqindje më të lartë të grave e vajzave në këshill sesa këshilltarë meshkuj.

Dominimi i numrit të këshilltareve në Tiranë erdhi edhe për shkak se partitë kanë respektuar kuotat gjinore dhe se në krye të listës së secilës parti kryesore më 2015 ka pasur gra e vajza kandidate.

Një lexim më i detajuar i listës nxjerr në pah faktin se më aktivët në Këshill janë figurat drejtues të grupeve në Këshilli, drejtuesit e vetë Këshillit, individët me poste në partitë kryesore politike si dhe individët që kanë kryesuar listat e kandidimit në zgjedhjet lokale 2015. Për shkak të angazhimit part-timë të këshilltarëve, drejtuesit e grupeve dhe figurat politike kryesore kanë edhe aktivitet më të fokusuar dhe mbajnë peshën kryesore të debateve në këshill dhe në përfaqësimin e tij në raport me institucionet e tjera dhe publikun.



Referuar ndarjes së listës së këshilltarëve më aktivë në bashkinë Tiranë, Kavajë, Kamëz, Vorë e Rogozhinë, rezulton se sipas forcave politike, partia kryesore politike në mazhorancë, PS, ka 5 këshilltarë shumë aktivë, PD në opozitë ka 9 këshilltarë shumë aktivë, LSI e cila më 2015 ishte pjesë e koalicionit fitues por që pas 2017 është në opozitë ka 4 këshilltarë shumë aktivë, ndjekur me nga një këshilltar për tri parti të vogla (PDIU, PBDNJ, PASH) dhe një këshilltare e pavarur (2018), e zgjedhur më 2015 në emër të FRD.

Vlen të theksohet fakti, se midis listës prej 22 emrave më aktiv në publik dhe media mbi problematikat lokale, gjenden edhe këshilltarë, të cilët kanë rekorde negative në angazhimin në mbledhjet e rregullta të Këshillit Bashkiak apo të komisioneve në Këshill. Zgjedhja e tyre për të qenë “i padukshëm” në Këshill dhe shumë aktivë në publik, është më shumë zgjedhje strategjike në funksion të karrierës politike publike sesa si zgjedhje e kushtëzuar nga mënyra sesi ndërvepron Këshilli apo organet e tjera vendimmarrëse në bashki.

Një shpjegim më i thelluar mbi këto raporte, - sesi mazhoranca është më pak aktive sesa opozita, - duket kërkuar në tri tipare të jetës politike në bashkitë e qarkut Tiranë.

- **Së pari**, shumica e këshilltarëve të mazhorancës në pushtet (PS) kanë poste të tjera të larta politike ose administrative dhe për pasojë, kanë angazhime të tjera më prioritare sesa fokusimi në mbledhjet part-time të këshillit bashkiak. Po ashtu, shumica e këshilltarëve të partive të tjera kanë angazhime paralele akademike, biznesi, etj, duke u kufizuar në ushtrimin prioritare të përgjegjësisive të këshilltarit bashkiak.
- **Së dyti**, vendimmarrja në pushtetin vendor është kryesisht vertikale dhe kryetari i bashkisë ka kompetenca e ushtrim maksimal pushteti në raport edhe me aktivitetin e këshillit. Për rrjedhojë, në rastet kur kryetari i bashkisë i përket partisë në pushtetin qendror apo kur forca politike e kryetarit të bashkisë ka mazhorancën në këshill, këshilltarët e mazhorancës dublohen nga titullarët e bashkisë, ndaj ata nuk kanë interes direkt në debatet politike që zhvillohen në këshill. Në rastet kur forca politike e kryetarit të bashkisë është e ndryshme nga forca politike që drejton pushtetin qendror, apo kur forca politike e kryetarit nuk është mazhorancë edhe në këshillin bashkiak, këshilltarët kanë më shumë hapësirë për ushtrimin e aktivitetit të tyre.
- **Së treti**, për një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit të Këshillit bashkiak, si në rastin e Tiranës, Kamzës, etj, partia që ka drejtimin politik të qytetit ka siguruar vota shtesë nga partitë e vogla të opozitës dhe për rrjedhojë, vendimmarrja e shumicës është garantuar. Për më tepër, në një pjesë të vendimmarrjeve të rëndësishme, sidomos në Tiranë, partitë kryesore të opozitës kanë bojkotuar ose kanë protestuar në momentet e vendimmarrjes,

duke ndikuar edhe në rënien e interesit politik të këshilltarëve që bëjnë kuorumin në sallë, për të luajtur rol protagonist edhe në debate.

NGA PËRDORIMI POZITIV I MEDIAS TEK VETË-PËRDORIMI SI PËRCJELLËS PARTIAK

Analiza e aktivitetit të këshilltarëve të bashkisë Tiranë dhe katër bashkive të tjera të qarkut Tiranë, nuk paraqet vetëm anën statistikore të aktivitetit nominal dhe kolektiv, por edhe elementë të tjerë me interes publik që lidhen me angazhimin ose mosangazhimin e tyre në media dhe në publik. Lidhur me format sesi këshilltarët i përdorin mediet apo bashkëveprojnë me to, konstatohen dy trende të kundërta:

- nga njëra anë është përpjekja për ta përdorur medien si instrument pozitiv që siguron audiencë të gjerë, ndikon në profilizimin dhe identitetin politik të kandidatëve, lehtëson komunikimin me qytetarët dhe kompenson edhe problemet e ndryshme që hasen gjatë ushtrimit të funksionit të këshilltarit.
- nga ana tjetër, është zgjedhja e një numri të madh të këshilltarëve për tu vetë-përdorur përmes medias, si përcjellës të mesazhit partiak.

Konkretisht, pjesa më e madhe e këshilltarëve që janë “aktivë” deri tek ata më “pak aktivë”, janë kryesisht përcjellës formal të lajmeve, videove, kronikave dhe elementëve të tjerë të raportimit mediatik të partisë së tyre politike, të liderit të tyre politik ose të institucionit të bashkisë (kur ata i përkasin partisë politike të kryetarit të bashkisë).

- Luajtja e rolit përcjellës dhe propagandues të partisë dhe kryetarit, institucionit ose liderit, përveçse dëmton identitetin e vetë këshilltarit në raport me publikun e gjerë, shërben edhe si mburojë politike në rast kritike nga forca politike që i përket, lidhur me aktivitetin apo efikasitetin e munguar. Ka raste madje, përfshirë edhe në Tiranë, ku këshilltarët janë aktivë në promovimin e partisë së tyre dhe liderit të tyre politik, por sapo ata ndryshojnë kah politik, ndryshojnë tërësisht sjelljen, duke u kthyer në promovues të liderit të ri dhe partisë së re politike ku adresojnë.
- Element tjetër i rëndësishëm është fakti se vetëm një numër shumë i kufizuar këshilltarësh, kryesisht në Tiranë, shkruajnë në media, dalin në emisione televizive ose postojnë në rrjete sociale për çështje e problematika që lidhen me funksionin e tyre këshillues dhe përfaqësues. Shumica e postimeve, daljeve dhe preferencave mediatike të atyre që bëjnë pjesë edhe tek kategoria “shumë aktivë” dhe “pjesërisht aktivë” lidhet më shumë me cilësitë, pasionet, hobet dhe elementë të tjerë të reklamës publike personale sesa me aktivitetin zyrtar e politik në funksionin e këshilltarit bashkiak.

-
- Së fundi, element tjetër tipizues është trendi për të komentuar ngjarje politike ose vendimmarrje në bashki, pasi ato kanë ndodhur, jo përpara tyre. Kjo formë e reagimit shpeshherë kushtëzohet me mungesën e transparencës paraprake apo problemet në vendimmarrje, si dhe me reagimin kritik publik ndaj vendimmarrjeve. Bashkitë nuk kanë aplikuar forma aktive komunikimi, si p.sh, konferenca shtypi pas çdo vendimmarrjeje ku informohet publiku në debate dhe për qëndrimet pro e kundër të grupeve në Këshill, dhe vetë këshilltarët nuk kanë krijuar ende mekanizma të tillë të rregullt deklarimi, të ngjashëm me grupet parlamentare në Kuvend.